



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1393/24 Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

#### V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
  - *Programi Fillor BA 240 ECTS*, me kuotën maksimumi **120 studentë** për vit akademik;
- II. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
  - *Edukimi në fëmijëri të hershme (0-6 vjet) BA 240 ECTS*, me kuotën maksimumi **60 studentë** për vit akademik;
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Faqe 1 nga 2

## ARSYETIM

Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Programi Fillor BA 240 ECTS	Hatixhe Ismaili Vjollca Ahmedi Teuta Danuza Jehona Rrustemi
2.	Edukimi ne fëmijëri te hershme (0-6 vjet) BA 240 ECTS	Rozafa Ferizi Shala Albulena Metaj Macula Ganimete Kulinxha Adelina Hajrullahu

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; Programi Fillor BA 240 ECTS**, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Elene Jibladze, Juliette Torobian, Milan Pol dhe Domagoj Svirig student, është organizuar më 28.03.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3), ndërsa Substancialisht katër (4) fusha të standardeve.
- Për programin e studimit; Edukimi ne fëmijëri te hershme (0-6 vjet) BA 240 ECTS**, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Juliette Torobian, Elene Jibladze dhe Domagoj Svirig, është organizuar më 28.03.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), ndërsa Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të, të mbajtur më datë 25.06.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Edukimit në UP;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hashija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Faqe 2 nga 2